



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA DOGANËS DURRËS

Nr. 5485 Prot.

Durrës, më 08 /04/2024

**Lënda:** Kërkesë për Shpallje Publike

**Drejtuar:** DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

DREJTORISË SË PLANIFIKIMIT DHE ANALIZËS SË TË ARDHURAVE  
Sektorit të Monitorimit të Borxhit

DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë

Në vijim të marrjes së masave për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor, mbështetur në Ligjin "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 të D.P.D-së "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës", Kreu VI "Njoftimi i Vendimit", pika 3, b) "Rastet e mos marrjes së konfirmimit të njoftimit", si dhe në zbatim të nenit 130-141/a të Kodit të Procedurës Civile, Ju drejtohem për të mundësuar njoftimin e subjektit debitor të poshtëshënuar pasi nga ana jonë nuk është mundësuar Njoftimi Vendimit për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor:

Nr	Vendimi Administrativ		Vendimi Rikuperim me Forcë		Subjekti debitor		Detyrimi	Penalitete	SHUMA
	Nr.	Data	Nr.	Data	Emri	Nipti			
1	70	17.01.2024	49	21.03.2024	SHKELZEN GJOCAJ	L00013277P	7,642	0	7,642

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

KRYETARI  
DENIS SHABANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA DOGANËS DURRËS

Nr. 4727 Prot.

Durrës, më 25.03.2024

**VENDIMI Nr.49, datë 21.03.2024**  
**PËR RIKUPERIMIN ME FORCË TË BORXHIT DOGANOR/AKCIZË**

Në zbatim të Ligjit nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; VKM Nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”; Ligji nr.61/2012 “Për Akcizen në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

**Ju njoftojmë se:**

Dega e Doganës Durrës me vendimin Nr.70, datë 17.01.2024, ka vendosur për subjektin/shtetasin “**SHKËLZEN GJOCAJ**” me Nipt / ID / PASS USA 666592538 (ID ne asycuda L00013277P), të shpallet debitor për shumën 7,642 lekë në formë detyrimi doganor, si dhe kamat vonest deri në ekzekutimin e detyrimeve të papaguara.

Ky vendim Ju është njoftuar përmes shkresës Nr.891Prot., datë 17.01.2024, me anë të shërbimit postar, Konferma Postare nr. RR567115865AA, në adresën e agjensisë doganore “Spedalb” si përfaqesues i terthort në deklarimin në doganë, në datë 31.01.2024. Gjithashtu është kryer edhe shpallja online pranë faqes zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në datë 26.01.2024.

Në kushtet kur nga ana Juaj nuk është ushtruar ankimim ndaj vendimit administrativ, Dega e Doganës Durrës në zbatim të nenit 280 të Kodit Doganor/ nenit 103 të ligjit 61/2012 “Për Akcizen në Republikën e Shqipërisë” ka nxjerrë Vendimin Nr.49, datë 21.03.2024 “Për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor/Akcizës”.

Përmes vendimit Nr.49, datë 21.03.2024 “Për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor/Akcizës”, Dega e Doganës Durrës ka vendosur si me poshtë;

1. Sekuestrimin e vlerave monetare, kredive, sendeve me vlerë të çmuar, dokumentave me anë të të cilave bëhen pagesa, valutave të huaja të depozituara në banka, që i përkasin debitorit, Subjektit/shtetasit “**SHKËLZEN GJOCAJ**” me Nipt / ID / PASS USA 666592538,, personave të tretë ose garantuesve që kanë detyrime kundrejt debitorit;
2. Sekuestrimin e mallrave, pasurive të tundshme ose të patundshme që i përkasin debitorit Subjektit/shtetasit “**SHKËLZEN GJOCAJ**” me Nipt / ID / PASS USA 666592538,, ose një pale të tretë ose garantuesit që ka detyrime kundrejt debitorit.
3. Kryerjen e sekuestrimit të mesipërm deri në masën , që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve për tu paguar nga subjektit Subjektit/shtetasit “**SHKËLZEN GJOCAJ**” me Nipt / ID / PASS USA 666592538 të percaktuar me vendim Nr.70, datë 17.01.2024, në shumën 7,642 lekë në formë detyrimi doganor, si dhe kamatë vonesat e lindura sipas nenit 107 të Kodit Doganor/Ligjit të Akcizës, në përputhje me normat bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë, për cdo ditë vonesë, nga data e njoftimit të debitorit, deri në datën e likuidimit të të gjitha detyrimeve të papaguara.

KRYETARI  
DENIS SHABANI